



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 4157/16 Prot.

Tiranë, më 22/01/2013

**Lënda:** Urdhër për kontrolluesin **Gjykata e Apelit Durrës**.

U R D H E R  
Nr 04, datë 22/01 2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr.225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të Kontrolluesit **Gjykata e Apelit Durrës**;

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhërit nr.206, datë 07.11.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar inspektim administrativ pranë kontrolluesit, **Gjykata e Apelit Durrës** me objekt:

- **Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale në publikimin e të dhënave sipas vendimeve gjyqësore nga kontrolluesi bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit Nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”.**

Në përfundim të inspektimit administrativ rezultoi se:

- Kontrolluesi “**Gjykata e Apelit Durrës**” aktualisht nuk disponon një portal zyrtar të institucionit dhe për këtë arsye nuk realizon publikim të vendimeve gjyqësore, por nga ana tjetër rezulton se këto vendime publikohen të plota në portalin [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) i

cili menaxhohet nga Ministria e Drejtësisë. Në kuptim të nenit 3 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" kontrollues i të dhënave personale të pasqyruara në Vendimet Gjyqësore është Gjykata e Apelit Durrës për shkak se ky i fundit është subjekti i cili mban, përpunon, administron, arkivon këto të dhëna. Vendimet që publikohen në portalin e sipërcituar janë ato që Gjykata e Apelit vë në dispozicion. Për këtë arsye, detyrimi për respektimin e dispozitave ligjore dhe Udhëzimit Nr. 15, datë 23.12.2011 "*Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor*", bie mbi këtë Gjykatë.

- Kontrolluesi "*Gjykata e Apelit Durrës*" nuk disponon një kontratë të shkruar në lidhje me administrimin, shërbimin dhe mirëmbajtjen e sistemit ICMIC (sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore);
- Nuk konstatohet një dokument i shkruar në të cilën të jenë të përcaktuara qartë nivelet e aksesit dhe rregullimi i marrëdhënieve me kontrolluesin Ministria e Drejtësisë.
- Kontrolluesi "*Gjykata e Apelit Durrës*" nuk ka masa teknike të përshtatshme në ambientin ku është vendosur serveri. Në këtë ambient konstatohet prani e lagështisë nëpër mure, mungese e një serveri sekondar për të garantuar disponueshmërinë e sistemit ICMIC dhe realizim i procedurave të ruajtjes së të dhënave të cilat ndodhen në sistem.

Për sa më sipër parashtruar, kontrolluesi Gjykata e Apelit Durrës rezulton të jetë në shkelje të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit Nr. 15, datë 23.12.2011 "*Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor*".

**Në këto kushte:**

## **URDHËROJ**

1. Në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" dhe udhëzimit nr. 15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "*Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor*":
  - Të pezullohet menjëherë publikimi në faqen zyrtare në internet, i vendimeve gjyqësore dhe çdo dokumentacioni që mbart të dhëna personale (*të pa anonimizuara*), të subjekteve që marrin pjesë në këto procese gjyqësore, deri në marrjen e masave ku publikimi i tyre, të bëhet me të dhënat personale të anonimizuara, konform kërkesave të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" të ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 15 datë 23/12/2011 "*Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor*".



- Të hartohen rregulla për mënyrën e mbledhjes, përdorimit, konfidencialitetit dhe ruajtjes në *Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore* të të dhënave personale të subjekteve që marrin pjesë në proceset gjyqësore.
  - Të përcaktohen rregulla të shkruara ku të jenë përcaktuar të drejtat dhe detyrat e kompanisë e cila menaxhon anën teknike të programit ICMIS, si dhe kompanisë që menaxhon faqen zyrtare në internet, lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve pjesëmarrës në proceset gjyqësore.
  - Të marren masa teknike dhe organizative të përshtatshme për ambientet ku është vendosur serveri, për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, për mbrojtjen e aksesit ose përhapjen e pa autorizuar.
2. Kontrolluesi “*Gjykata e Apelit Durrës*” mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me zbatimin e detyrave të lenë në këtë urdhër.
  3. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit... *Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.*

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

